

***PROGRAMI
KOMBËTAR
I
ZHVILLIMIT
TË GJUETISË***



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MJEDISIT

DOKUMENT DRAFTI

***NË LIDHJE ME DISKUTIMIN MBI PROGRAMIN KOMBËTAR TË
ZHVILLIMIT TË GJUESISË NË SHQIPËRI NË DATËN 4 NËNTOR 2014***

TABELA E PËRMBLEDHJES

I. HYRJE	4
1.1 Programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë realizohet:.....	4
II. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT KOMBËTAR TË ZHVILLIMIT TË GJUEISË	5
2.1 Politika shtetërore për gjuetinë.....	5
2.2 Qëllimi dhe Objektivat.....	6
III. MASAT PËR ZHVILLIMIN E GJUEISË SË QËNDRUESHME	7
3.1 Kuadri institucional.....	7
3.2 Kuadri ligjor	7
3.3 Marrëdhëniet me aktorët e tjerë	8
3.4 Ekspertiza shkencore	8
3.5 Bashkëpunim me Federatat dhe Shoqatat e Gjuetarëve.....	8
3.6 Bashkëpunim me operatorët e gjuetisë turistike.....	8
IV. ZONAT E GJUEISË - RRJETI I ZONAVE TË GJUEISË NË SHKALLË VENDI	9
4.1 Menaxhimi i aktivitetit të gjuetisë.....	10
V. LLOJET E FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUEIE	11
VI. KUOTAT VJETORE TË VJELJES PËR ÇDO LLOJ TË FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUEIE	12
6.1 Investimet, projektet dhe ndërhyrjet përmirësuese për çdo zonë gjuetie	13
VII. SHTIMI I POPULLATAVE TË LLOJEVE, OBJEKT GJUEIE DHE SHPËRNDARJA E INDIVIDËVE NË ZONA	14

I. HYRJE

1.1 Programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë realizohet:

Si një detyrim në zbatim të ligjit "Për gjuetinë" sikurse dhe një plotësim i kuadrit ligjor në fushën e biodiversitetit, të mbrotjes së faunës së egër dhe mirëmenaxhimit të saj;

Në përputhje me kërkesat e Programit të Qeverisë në fushën e mbrotjes së mjedisit, vecanërisht këtu në fushën e mbrotjes së natyrës dhe biodiversitetit;

Në përputhje me qëllimet e Konventave të fushës së natyrës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe të habitateve të tyre natyrore dhe të Direktivave të BE-së për fushën e mbrotjes së natyrës;

Duke marrë parasysh që menaxhimi i integruar i ekosistemeve dhe ruajtja e habitatit sigurojnë kushtet për ruajtjen e biodiversitetit dhe duhet të ecin paralel me masat për mbrotjen e llojeve të faunës së egër;

Duke vlerësuar se përdorimi i qëndrueshëm i komponentëve të larmisë biologjike është një ndër tre objektivat e CBD - Konventës për Diversitetin Biologjik, Konventës ndoshta më të rëndësishme të natyrës e biodiversitetit, që synon ruajtjen e diversitetit biologjik të ekosistemeve, llojeve dhe popullatave, si dhe ndryshueshmërinë e tyre natyrore gjenetike, me qëllim të arritjes së një ekuilibri mes mbrotjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të larmisë biologjike;

Me vetëdijen se identifikimi i proceseve dhe kategoritë e veprimtarive që kanë ndikim të rëndësishëm negativ në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të larmisë biologjike (siç është e shprehur në nenin 7 të Konventës për Diversitetin Biologjik, CBD), janë gjithashtu me rëndësi të madhe për ruajtjen e llojeve të kërcënuara;

Në kuadër të transpozimit dhe zbatimit në praktikë të Direktivës së Shpendëve (2009/147/EC) të BE-së si Direktiva kryesore që vendos dispozitat për një sistem të përgjithshëm mbrotje për gjithë llojet e shpendëve të egër - sipas dispozitave të kësaj Direktive llojet e listuara në Aneksin II, mund të gjuhen, përsa kohë kjo gjueti duhet t'i nënshtohet rregullave të caktuara; kjo Direktivë vendos status mbrotje për të gjithë llojet e shpendëve të egër; limiton gjuetinë vetëm për llojet e listuara në Aneksin II; kërkon që aktiviteti i gjuetisë të mos dëmtojë përpjekjet për ruajtje për llojet e Aneksit II dhe që aktiviteti i gjuetisë të përputhet me parimin e "përdorimit të mençur" dhe të kontrollit të balancuar ekologjik; ndalon gjuetinë gjatë periudhës së kthimit të llojeve migratore në vendet e shumimit dhe gjatë sezonit të shumimit;

Në mbështetje të zbatimit të dokumenteve strategjike ndërkombëtar:

- Vendimit V / 6 i Konferencës së Palëve në CBD mbi Qasjen Ekosistemit, miratuar në vitin 2000, dhe duke përfshirë 12 parimet e Qasjes së ekosistemit;

- Rezolutës së Kievit të vitit 2003 për biodiversitetin, e cila përfshin angazhimin për "të ndaluar humbjen e biodiversitetit deri në vitin 2010", të miratuar nga ministrat e mjedisit dhe Kryetarët e delegacionit nga 51 vendet në rajonin pan-evropian;
- Deklaratës së Strasburgut të vitit 2004 për rolin e Konventës së Bernës në ruajtjen e diversitetit biologjik, si dhe nevojën për të përforcuar zbatimin dhe koherencën e instrumenteve globale dhe evropiane të biodiversitetit të tilla si Konventa mbi Diversitetin Biologjik dhe Direktivat e Habitave dhe të Shpendeve të BE-se;
- Vendimit VII / 12 të Konferencës së Palëve në CBD për Përdorimin e Qëndrueshëm, miratuar në vitin 2004, dhe duke përfshirë edhe parimet e Adis Abeba dhe Udhëzimet për Përdorimin e Qëndrueshëm të Biodiversitetit;
- Objektive të Zhvillimit të Mijëvjeçarit;
- Rekomandimit 1689 (2004) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, në lidhje me gjuetinë dhe bilancin e mjedisit të Evropës;
- Vlerësimin e Biodiversitetit Global – lançuar në Tetor 2014 nga UNEP;
- Iniciativës “Gjuetia e qëndrueshme dhe Natura 2000”, të Komisionit Evropian, 2001 që synon të promovojë dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet organizatave mjedisore dhe gjuetarëve për të arritur dhe për të zgjeruar gjuetinë e qëndrueshme dhe në përputhje me Direktivën e Shpendëve;
- Kartës Evropiane për Gjuetinë dhe Biodiversitetin (2007), e cila përcakton se Gjuetia e qëndrueshme është “Përdorimi i mençur i llojeve të faunës së egër objekt gjuetie dhe të habitave të tyre në mënyrë dhe në një shkallë të tillë që nuk çon në terma afatgjatë në humbjen (rënien drastike) të biodiversitetit ose që çënon rimëkëmbjen e tij” - ky përdorim siguron potencialin e biodiversitetit për të përmbushur nevojat e gjeneratave të sotme dhe të ardhshme, si dhe për të mbajtur gjuetinë si një aktivitet social, ekonomik dhe kulturor të pranueshëm. Vetëm nëse kryhet në mënyrë të qëndrueshme gjuetia kontribuon në ruajtjen e popullatave të llojeve të faunës së egër dhe të habitave të tyre si dhe në përfitim të shoqërisë.

II. OBJEKTIVAT E PROGRAMIT KOMBËTAR TË ZHVILLIMIT TË GJUEISË

2.1 Politika shtetërore për gjuetinë

PKZhGj është dokumenti kryesor që shërben për të siguruar mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit dhe komponentëve të tij dhe për menaxhimin e aktivitetit të gjuetisë së qëndrueshme, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, nëpërmjet përdorimit të drejtë që siguron ruajtjen e llojeve të faunës së egër objekt gjuetie, dhe jo vetëm, por dhe të habitave të tyre natyrore.

Programi kombëtar i zhvillimit të gjuetisë do të shërbejë si një dokument bazë për të realizuar një veprimtari gjuetie të qëndrueshme dhe në përputhje me objektivat për mirëadministrimin e popullatave të llojeve të faunës së egër objekt gjuetie. Programi kombëtar, në bazë të politikave shtetërore për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, synon që brenda një periudhe 10 vjeçare të rikthejë veprimtarinë e gjuetisë jo vetëm në një aktivitet çlodhës e rekreacioni, por si një aktivitet njerëzor me karakter sportiv të kontrolluar. Kjo do të bëjë të mundur krijimin e kushteve për zhvillimin, rimëkëmbjen dhe shtimin normal të faunës së egër, nëpërmjet mbrojtjes dhe mirëadministrimit të saj si edhe përmirësimin e treguesve të natyrës e të biodiversitetit, sidomos kjo për llojet e faunës së egër objekt gjuetie.

Ushtrimi i aktivitetit të gjuetisë, duke marrë individë të llojeve të faunës nga jeta e egër, ka një ndikim në një pjesë të caktuar të burimeve natyrore. Gjuetia ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi diversitetin gjenetik të llojeve objekt gjuetie dhe strukturën e popullatave të tyre, si dhe një ndikim indirekt në llojet e faunës jo-huntabile si dhe lloje bimore dhe tokës. Ky ndikim ka efekte mbi ekosistemet dhe, në disa raste, ka një potencial për konflikt me interesat e përdoruesve të tjerë të burimeve natyrore (p.sh. pyje, bujqësi, rekreacion etj).

2.2 Qëllimi dhe Objektivat

Ruajtja e vlerave të biodiversitetit në përgjithësi dhe mbrojtja e faunës së egër objekt gjuetie në veçanti, duke mirëadministruar atë, do të përbëjnë thelbin e veprimtarisë së aktorëve institucioneve dhe organizatave, duke shprehur kështu garancinë që kjo veprimtari do të kryhet mbështetur mbi parime që do zbatohen në mënyrë rigoroze. Tërësia dhe barazpesha ekologjike, në këtë mënyrë do të jenë të garantuara.

Nga ana tjetër masat për mbrojtjen e faunës duhet të ndërliken me mbarështimi dhe përmirësimi i habitateve të faunës së egër, vecanërisht i asaj objekt gjuetie, si areali ku lind e zhvillohet kjo faunë. Ky do të jetë një nga objektivat parësor jo vetëm i strategjive dhe planeve të fushës së natyrës e biodiversitetit, por në mënyrë të vecantë i planeve dhe programeve që do të realizohen posaçërisht për menaxhimin e territoreve natyrore që janë edhe pjesë zonave të gjuetisë. Ministria e Mjedisit në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet planeve dhe projekteve të saj, të drejtojë dhe kontrollojë procesin e përmirësimit të gjendjes së habitateve të zonave të gjuetisë.

Qëllimi kryesor do të jetë që veprimtaria e gjuetisë të vendoset mbi rregulla të plota, e lidhur kjo me zonat e gjuetisë të përcaktuara qartë, e që do ta shtrijnë efektin e tyre si për sa i përket aspekteve sportive e rekreacionale të gjuetisë, rregullimin e veprimtarive menaxhuese, të mbrojtjes e mosdëmtimit të llojeve të faunës së egër dhe të habitateve të tyre, etj.

Programi kombëtar i gjuetisë, në përputhje me kërkesat për zhvillimin e qëndrueshëm, krahas ripërtëritjes së popullatave të faunës së egër, objekt gjuetie, do të bëjë të mundur që ta fusë në veprimtarinë e gjuetisë dhe menaxhimin e faunës së egër mekanizma financiar të cilat do të bëjnë të mundur mbështetjen e aktiviteteve të kontrollit, monitorimit dhe inventarizimit të faunës, aktivitete sensibilizuese për mbrojtjen e faunës, etj. Do të synohet nxitja dhe aplikimi i incentivave ekonomike në fushën e menaxhimit të faunës së egër objekt gjuetie nëpërmjet investimeve publike dhe private në këtë drejtim.

Ministria e Mjedisit brenda kohës së realizimit të këtij programi kombëtar gjuetie, do të realizojë të gjithë ndërhyrjet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe atë institucional, për të bërë të mundur arrijtjen e këtij objekti.

III. MASAT PËR ZHVILLIMIN E GJUETISË SË QËNDRUESHME

Sot në botë ka disa përkufizime ose përcaktime për qëndrueshmërinë e aktiviteteve humane në përdorimin e burimeve natyrore. Në Konventën e Diversitetit Biologjik me “përdorim të qëndrueshëm” nënkuptohet përdorimi i elementëve përbërës të larmisë biologjike në një mënyrë dhe shkallë të tillë që të mos çojë në shuarjen në të ardhmen e largët të larmisë biologjike dhe si rezultat të ruajë potencialin e saj për plotësimin e nevojave dhe aspiratave të brezave të sotëm dhe të ardhshëm. Në Konferencën e Palëve të zhvilluar në Tetor 2014, e mbajtur në Pyeongchang (Republika e Koresë), u kërkua me forcë menaxhimi i qëndrueshëm i faunës së egër që shikohet si një çështje kyçe në drejtimin e biodiversitetit. Për këtë është ngritur Partneriteti Bashkëpunues për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Jetës së Egër (Collaborative Partnership on Sustainable Wildlife Management-CPW), që përbën një partneritet vullnetar të organizatave ndërkombëtare me mandat dhe program të qartë për përdorimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e burimeve të jetës së egër.

Gjithashtu në Europë janë aprovuar nga vendet e Komunitetit European, ku edhe vendi ynë sot aderon me statusin e vendit kandidat, Direktiva e Shpendëve dhe dokumenta të tjerë (Karta Europiane për Gjuetinë dhe Biodiversitetin) të cilat përcaktojnë detyrimet ligjore dhe mënyrën e kryerjes dhe ndalimit të aktivitetit të gjuetisë në raport me ruajtjen e faunës së egër.

Për këtë arsye Programi Kombëtar përcakton si të domosdoshëm një seri masash të detajuara që mund të zhvillohen më tej me kalimin e kohës:

3.1 Kuadri institucional

- Ngritja e një strukture ndërinstitucionale pranë Ministrisë së Mjedisit, e cila do të ketë një rol konsultativ për vendimarrjen në lidhje me menaxhimin e aktivitetit të gjuetisë, por nga ana tjetër do të informojë dhe kordinojë punën me institucione të rëndësishme për mbarvajtjen e aktivitetit të gjuetisë në vend;
- Rialokimi i stafit në zyrat e shërbimit pyjor në rrethe por edhe jasht saj, për të siguruar personelin e nevojshëm për supervizimin dhe kontrollin e aktivitetit të gjuetisë;
- Mbështetja e zbatimit të një database (portali të dedikuar), i cili do të bëjë të mundur vendosjen nën kontroll të aktivitetit dhe të armëve të gjuetisë.

3.2 Kuadri ligjor

- Amendimi i ligjit të gjuetisë, por edhe të një pakete me akte nënligjore që e bën më të lehtë zbatimin e detyrimeve ligjore;

- Përcaktimi i saktë i mënyrës së organizimit të aktivitetit të gjuetisë (me bazë ligjore) i cili nuk lë shteg për interpretime dhe keqkuptime të cilat shfrytëzohen në terren për aktivitet të paligjshëm.

3.3 Marrëdhëniet me aktorët e tjerë

- Vendosja e marreveshjeve të bashkëpunimit dhe punës së përbashkët me institucionet edukimit (arsimi universitar dhe para universitar), në dy drejtime kryesore: (i) zhvillimi i studimeve dhe ndërtimi i bazeve të të dhënave për procesin e vendimarrjes, dhe (ii) informimi dhe edukimi në procesin e mesimdhënies e mësimnxënies për nxënësit e arsimit para universitar;
- Formalizimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit me organizatat e shoqërisë civile për koordinimin e procesit

3.4 Ekspertiza shkencore

- Inventarizimi i gjëndjes së faunës së egër si një studim bazë për vazhdimin e punës të planifikimit të aktivitetit të gjuetisë;
- Zhvillimi i një sistemi të përhershëm monitorimi si të aktivitetit të gjuetisë ashtu dhe atij të gjëndjes së faunës së egër, që do ta bëjë me transparent e të besueshëm vendimarrjen politike për mbrojtjen dhe ruajtjen e faunës së egër.

3.5 Bashkëpunim me Federatat dhe Shoqatat e Gjuetarëve

- Forcimi i bashkëpunimit ekzistues duke synuar përfshirjen dhe kontributin e tyre aktiv në procesin e administrimit të aktivitetit të gjuetisë;
- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të tyre në komisionet e testimit për gjuetarët e rinj;
- Alokimi për dhënie në përodrim të zonave të caktuara të gjuetisë për federatat dhe/ose shoqatat e gjuetarëve;
- Edukimi dhe rritja e ndërgjegjes së komunitetit të gjuetarëve sportivë si një nga sfidat më të medha për qëndrueshmërinë e planit për mbrojtjen dhe shtimin e faunës së egër në vendin tonë. Nuk mund të ketë rezultate pozitive në rast se nuk mund të investojmë në ndryshimin e një mentaliteti që e quan normale mbajtjen dhe përdorimin e një arme gjuetie, por edhe vrasjen e jetës së egër, nga persona që jo vetëm nuk plotësojnë kërkesat e ligjit por që nuk kanë edhe formimin e duhur për armëmbajtjen.

3.6 Bashkëpunim me operatorët e gjuetisë turistike

- Bashkëpunim i vazhdueshëm me këta operatorë duke synuar përfshirjen dhe kontributin e tyre në procesin e mirëadministrimit të aktivitetit të gjuetisë;
- Rritja e ndërgjegjësimit të tyre, që një gjueti e zhvilluar në limitet që përcaktojnë planet e menaxhimit, është premisë për zhvillimin afatgjatë e fitimprurës të gjuetisë në të gjithë planet – për biznesin, për jetën e egër dhe biodiversitetin, sikurse edhe për të gjithë shoqërinë.

IV. ZONAT E GJUE TISË - RRJETI I ZONA VE TË GJUE TISË NË SHKALLË VENDI

Përcaktimi i zonave të gjuetisë është një nga hapat më të rëndësishëm të planifikimit dhe kontrollit të aktivitetit për gjuetinë e llojeve të faunës së egër. Zonat e gjuetisë duhet të përcaktohen mbi bazën e të dhënave dhe kritereve të cilat bëjnë të mundur identifikimin, strukturimin, kontrollin dhe vlerësimin e saj për gjendjen e faunes. Duke qene se sot kemi pak të dhena atehere mendohet te perpunohen hartohet kritere te forta dhe te miret mendimi i eksperteve lokale dhe i organeve vendore. Gjithashtu vendimi për ndarjen e re vendore do të kihet parasysh në përcaktimin dhe delimitimin e zonave të gjuetisë, duke filluar nga një numër sa më i vogël i zonave të cilat mund të menaxhohen e kontrollohen me lehtësi nga strukturat/personat që do të caktohen.

Mbi bazën e zonave të gjuetisë që miratohen për çdo rreth, do të ngrihet dhe të funksionojë rrjeti i zonave të gjuetisë në shkallë vendi, si një njësi territori që do të sigurojë këmbimin e vazhdueshëm e të ndërsjellët të të dhënave, informacioneve, menaxhimit të proceseve, eksperiencave, etj, si ndërmjet zonave të gjuetisë, e strukturave të tyre menaxhuese, ashtu dhe ndërmjet tyre e strukturave në qendër të Ministrisë së Mjedisit.

Rrjeti i zonave të gjuetisë në shkallë vendi përfshin sot një total prej 254 zonat e gjuetie, të miratuara nëpërmjet urdhërave përkatës të ministrit të mjedisit dhe të propozuara nga DSHP-të. Me fillimin e sezonit të ri do të rishikohen totali i tyre duke kërkuar të lihen zona të lira për kafshët e egra dhe përcaktuar kufijtë e saktë për ato që do të përbëjnë rrejtin. Ky rrjet do të reflektojë në vazhdimësi të gjithë ndryshimet që mund të ndodhin me zonat e gjuetisë, si ato që kanë të bëjnë me konfigurimin nga pikëpamja e shtrirjes fizike dhe kufijve gjeografikë, ashtu edhe me elementët përbërës sikurse janë në rradhë të parë llojet objekt gjuetie, përhapja e tyre, etj.

Për të unifikuar të dhënat për rrjetin e zonave të gjuetisë në shkallë vendi, Ministria e Mjedisit brenda dy vitesh nga hyrja në fuqi e vendimit për zonat, do të standartizojë dokumentacionin që duhet për menaxhmin dhe regjistrimin e zonave të gjuetisë, duke përcaktuar për secilën zonë gjuetie të gjithë të dhënat e nevojshme që pasqyrojnë gjuetinë dhe veprimtarinë menaxhuese të saj.

Si një hap bazë në procesin e krijimit të rrjetit të zonave të gjuetisë dhe të unifikimit të të dhënave, do të jetë realizimi i procesit të dixhitalizimit të të gjitha zonave të gjuetisë brenda periudhës së moratoriumit të gjuetisë, duke pasqyruar kërkesat e pikave të mësipërme, të dhëna të tjera që mund të jenë specifike për ndonjë zonë gjuetie, sikurse dhe kërkesat e ligjit për sipërfaqet ku nuk është e lejuar gjuetia.

Mbi bazën e të dhënave mbi përhapjen e popullatave të llojeve, për çdo zonë të gjuetisë të pasqyrohen në hartën dixhitale të zonës së gjuetisë arealet e përhapjes për secilin lloj të faunës objekt gjuetie, duke bërë të mundur krijimin e hartave dixhitale në shkallë vendi me areal të përhapjes për secilin lloj të faunës objekt gjuetie, për të gjithë rrjetin e zonave të gjuetisë.

Ministria e Mjedisit ta realizojë këtë proces brenda një periudhe pesëvjeçare nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4.1 Menaxhimi i aktivitetit të gjuetisë

Si një detyrim ligjor thelbësor që lidhet me mirëfunksionimin e zonave të gjuetisë, hartimi i planeve efikase të menaxhimit një vjeçar të këtyre zonave si dhe i atyre 10 vjecare do të mbetet një prioritet që do të ketë reflektimin në menaxhimin e të gjithë rrjetit të zonave të gjuetisë. Ministria e Mjedisit do të bëjë planifikimet e nevojshme për të mundësuar hartimin nga strukturat e tyre menaxhuese të planeve 10 vjecare, në një kohë sa më të shkurtër. Arshivimi i këtyre planeve do të jetë pjesë e të gjithë dokumentacionit që mbahet për zonat dhe rrjetin e tyre në shkallë vendi. Zbatimi i planeve një apo 10 vjecare, do të jetë objekt i kontrollit nga strukturat përkatëse të ngarkuara me ligj dhe, natyrisht, do të jetë pjesë e dokumentacionit të zonave të gjuetisë dhe rrjetit të tyre në shkallë vendi.

Mënyra e menaxhimit dhe administrimit të zonave të gjuetisë, do të jetë pjesë e vendimarrjes në të ardhmen. Sot Drejtoritë Rajonale të Zyrat e Shërbimit Pyjor në rrethe kryejnë këtë detyre, por ka ardhur koha të rishikohet skema e funksionimit. Kjo pikë do të lidhet me aprovimin e akteve ligjore për këtë çështje por duhet të ndërmerret një debat me grupet e interesit si edhe vlerësuar realisht situatën në të cilin ndodhemi. Vendosja e një dualizmi midis organeve shtetërore dhe shoqatave të gjuetarëve (për të cilat kërkohet të rrisin kapacitetet dhe mënyrën e funksionimit), me pjesmarrjen e shoqërisë civile, mund të jetë një mundësi e mirë për të kaluar situatën e vështirë të krijuar si edhe mungesën e mjeteve financiare dhe kapaciteteve njerëzore. Megjithatë, si do që të jetë skema e menaxhimit të zonave të gjuetisë, në fund do të raportojnë në mënyrë periodike në Ministrinë e Mjedisit, si institucioni përgjegjës për kontrollin e këtij aktiviteti, e cila do të drejtojë dhe përgjigjet për mirëfunksionimin e të gjithë rrjetit të zonave të gjuetisë.

Përcaktimi me saktësi i detyrave institucionale për kontrollin, përfshirë edhe inspektoriatin, dhe menaxhimin e zonave do të jetë kyçi suksesit të këtij procesi. Sipas ligjit aktual menaxhuesi i zonës së gjuetisë përgjigjet për menaxhimin e zonës së tij të gjuetisë dhe të veprimtarisë së gjuetisë që zhvillohet në të. Vendosja e këtij roli në një zonë gjuetie është tepër i rëndësishëm dhe duhet të jetë edhe ky pjesë e rishikimit të akteve ligjore e nënligjore. Ai sot duhet të jetë përgjegjës për implementimin e programit kombëtar të gjuetisë dhe planit menaxhues për zonën e gjuetisë që ai menaxhon. Rrjeti i zonave të gjuetisë do të shoqërohet me një rrjet analog të menaxhuesve të zonave të gjuetisë, koordinimi i veprimtarisë së të cilëve dhe databaze për ta do të realizohet nga stafi teknik i Ministrisë së Mjedisit.

Monitorimi i gjuetisë si një proces i detyrueshëm që drejtohet nga ministria, dhe që përmbledh monitorimin e veprimtarisë së gjuetisë dhe monitorimin e zonave të gjuetisë, do reflektojë të dhënat e tij dhe në rrjetin e zonave të gjuetisë. Ministria e Mjedisit, koordinon e punën e të gjithë strukturave të lidhura me procesin, vecanërisht të DRSH-ve dhe AKM-së për realizimin e vazhdueshëm të këtij procesi. Nëpërmjet punës së tyre kërkohet të vihet rregull dhe të zbatohet ligji për kundravajtësit. Gjithashtu përfshirja e Policisë së Shtetit është një tjetër nevojë në kontrollin e aktivitetëve të paligjshme edhe në vazhdim të detyrave që Kryeministri i vendit i ka përcaktuar kësaj force në drejtim të shkatërrimit mjedisor në vendin tone.

Inventarizimi i llojeve objekt gjuetie si një proces i detyrueshëm vjetor dhe që drejtohet nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë, do të reflektohet gjithashtu në rrjetin e zonave të gjuetisë. Rëndësia e kryerjes me efektivitet dhe besueshmëri të këtij procesi është thelbësor dhe ndërvar të gjithë proceset vijuese të gjuetisë, prandaj ministria ta realizojë atë mbi baza sa më shkencore dhe organizative.

Brenda rrjetit të zonave të gjuetisë do të krijohen dhe përcaktohen zonat rezidenciale të gjuetisë për ushtrimin e gjuetisë. Ministria e Mjedisit, nëpërmjet DRSHP, brenda një periudhe 2 vjecare nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të bëjë propozimet e nevojshme për përmbushjen e këtij detyrimi në përputhje me kërkesat e ligjit “Për gjuetinë”.

Brenda rrjetit të zonave të gjuetisë do të krijohen dhe përcaktohen zonat e mundëshme për investime private apo publike për përmirësimin e shtimin e popullatave të faunës së egër, ashtu dhe rezervate gjuetie për mbarështimin e llojeve objekt gjuetie. Ministria e Mjedisit, nëpërmjet DRSHP, brenda një periudhe 2 vjecare nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të bëjë propozimet e nevojshme për përmbushjen e këtij detyrimi.

Në përcaktimin e zonave të gjuetisë do të kihet parasysh edhe nevoja për habitate dhe territore qetësie për faunën e egër, e nevojshme kjo për kryerjen e proceseve të shumimit dhe në disa raste të ushqimit të saj. Për këtë gjë ndalimi i gjuetisë në zonat e mbrojtura por edhe përcaktimi i disa zonave malore që janë të domosdoshme për disa lloje specimesh, duhet të jetë pjesë e analizës më parë krijimit të rrjetit të gjuetisë.

V. LLOJET E FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE

Gjuetia ushtrohet vetëm mbi individë të llojeve të faunës së egër, që janë shpallur objekt gjuetie me vendim të Këshillit të Ministrave. Referuar gjendjes aktuale në të cilën është fauna e egër objekt gjuetie, Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me aktorët dhe kriteret e përcaktuara në ligj, të rishqyrtojë rigorozisht procesin si dhe listën aktuale prej 17 llojesh të faunës së egër objekt gjuetie që propozohet për miratim.

Për të bërë të mundur një inventarizim të plotë e të saktë të llojeve objekt gjuetie në cdo zonë gjuetie, procesi do të iniciohet / realizohet nëpërmjet urdhërit të ministrit / kuadrit të mirëpërcaktuar ku do të parashikohen personat përgjegjës që do të realizojnë këtë proces krahas menaxhuesit të zonës së gjuetisë, kohën në të cilën do realizohet, të dhënat që duhet të inventarizohen, mënyrën e pasqyrit të tyre, etj.

Metodika e regjistrimit dhe inventarizimit të llojeve dhe popullatave të tyre, si dhe dokumentet e formatuara, ku pasqyrohen të dhënat dhe rezultatet e inventarizimit të llojeve, objekt gjuetie, miratohen me udhëzim të ministrit. Ministria do të koordinojë punën me rrethet shkencore e akademike për të vënë mbi baza sa më shkencore të gjithë procesin.

Menaxhuesit e zonave të gjuetisë, krahas grumbullimit të të dhënave për numrin e kafshëve të egra brenda zonës, grumbullojnë edhe të dhëna të tjera për gjendjen e kushtet e jetesës së kafshëve në zonën e gjuetisë dhe shënimet i dërgojnë në DSHP-në përkatëse, e cila mban regjistrin e kafshëve të egra të zonave të gjuetisë. Ministria do të koordinojë punën me rrethet shkencore e akademike për të vënë mbi baza sa më shkencore të gjithë procesin.

Nëpërmjet planeve vjetore të punës të zonave të gjuetisë, do të parashikohen masa për të bërë të mundur rritjen e numërit të individëve të popullatave të faunës së egër, objekt gjuetie, në ato qarqe në të cilat ka rënie të këtyre popullatave.

Brenda kohës së zbatimit të këtij programi gjuetie, nëpërmjet politikave dhe veprimtarive konkrete të ruajtjes së jetës së egër, lista e llojeve objekt gjuetie mund të rishikohet duke u mbështetur dhe përditësuar me të dhëna nga procesi i inventarizimit dhe monitorimit.

Në mënyrë që të sigurohet i plotë dhe pa rrezik për tu cënuar cikli riprodhues i llojeve objekt gjuetie nga gjuetia e parakohëshme apo e tejzgjatur, do të trajtohet me kujdes në çdo sezon gjuetie, kohëzgjatja e gjuetisë sipas llojeve si dhe ditët e lejuara për gjueti.

VI. KUOTAT VJETORE TË VJELJES PËR ÇDO LLOJ TË FAUNËS SË EGËR, OBJEKT GJUETIE

Kuotat vjetore të gjuajtjes për çdo lloj të faunës së egër objekt gjuetie, janë përlllogaritur mbi bazën e të dhënave të përpunuara shkencore, referuar biologjisë, kushteve të jetesës, ciklit riprodhues, etj për secilin lloj objekt gjuetie. Në mënyrë që një zonë gjuetie të jetë e vlefshme për gjueti efektive sportive dhe turistike, në planet 10 vjeçare të menaxhimit të zonës së gjuetisë, apo në planin vjetor të përdorimit të llojeve, do pasqyrohen të dhëna të përditësuara, duke filluar nga të dhënat kryesore për zonën e gjuetisë dhe duke vijuar me popullatat e çdo lloji objekt gjuetie, që është prezent në atë zonë.

Mbi bazën e të dhënave që dalin nga inventarizimi vjetor, në ligjin "Për gjuetinë" është sanksionuar që, kuota e planifikuar për t'u gjuajtur në sezonin e ardhshëm të gjuetisë nuk mund të jetë më shumë se 10 % e shtesës natyrale të popullatës për secilin prej llojeve të faunës së egër objekt gjuetie.

Mbi këtë bazë, menaxhuesi i zonës së gjuetisë dhe DRSHP-ja përkatëse, do të përlllogarisin si numërin e individëve që lejohet të gjuhen në zonën e gjuetisë ashtu dhe shtesat e popullatave për secilin lloj objekt gjuetie.

Në planet një apo 10 vjeçare të menaxhimit të zonës së gjuetisë, mbi bazën e numrit total të llojeve të faunës së egër objekt gjuetie të identifikuar dhe të vlerësuara për tu gjuajtur, **do të** llogaritet kapaciteti i zonës në terma të numrit maksimal të gjuetarëve që mund të ushtrojnë aktivitetin e gjuetisë sportive dhe turistike në zonë, duke u mbështetur për këtë në kohëzgjatjen e sezonit të gjuetisë dhe ditët e lejuara për gjueti të miratuara për secilin lloj objekt gjuetie.

6.1 Investimet, projektet dhe ndërhyrjet përmirësuese për çdo zonë gjuetie

Për të stimuluar krijimin e rezervateve që do të shërbejnë për mbarështim të faunës së egër, veçanërisht asaj objekt gjuetie, me synim hedhjen më pas të kësaj faune në zonat e gjuetisë, Ministria e Mjedisit, brenda një viti nga miratimi i këtij programi, do përgatisë ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme në aktet që planifikojnë marrjen e fondit pyjor apo kullosor me qera për krijim të rezervateve për mbarështim të faunës së egër, nëpërmjet uljes së kuotave të marrjes me qera të këtij fondi pyjor apo kullosor.

Aktiviteti i gjuetisë sportive dhe turistike, udhëhequr nga parimi i përdorimit të qëndrueshëm të popullatave të llojeve objekt gjuetie, do e realizojë këtë nëpërmjet një menaxhimi afatgjatë të planifikuar të këtyre llojeve, investimeve, projekteve dhe ndërhyrjeve përmirësuese për çdo zonë gjuetie, që do sigurojnë qëndrueshmërinë e popullatave dhe mbarështimin e llojeve.

Mbi bazën e të dhënave dhe analizave përkatëse për çdo zonë gjuetie, do të bëhet vlerësimi për gjendjen dhe ndërhyrjet e nevojshme që duhet të bëhen, duke nisur nga ato afatgjatë e prioritare e deri në ndërhyrjet e përhershme e të një karakteri të përditshëm, për të cilat ka nevojë çdo zonë gjuetie në proces menaxhimi. Ministria e Mjedisit dhe Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor të realizojnë këtë proces evidentimi dhe planifikimi për çdo zonë gjuetie, brenda dy/një vjetësh/viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Mbi bazën e të dhënave dhe analizave përkatëse për çdo zonë gjuetie, në mënyrë të vecantë do të bëhet identifikimi i të gjithë llojeve të faunës së egër, atyre objekt gjuetie, si dhe llojeve prioritar të faunës së egër objekt gjuetie popullatat e të cilave kanë trend negativ zhvillimi në vitet e fundit.

Për secilin prej llojeve të faunës së egër objekt gjuetie të pranishëm në zonë, veçanërisht për llojet me trend negativ zhvillimi:

- a. do të planifikohen masa konkrete që do të stimulojnë shtimin e numrit të popullatave të tyre, në mënyrë që të arrihet mbajtja e numrit të popullatave dhe të mos ketë rënie të tyre;
- b. do të propozohen plane veprimi për to, që do realizohen në një afat disavjekar.

Masat konkrete që do ndërmerren në llojet e faunës së egër objekt gjuetie do të konsistojnë:

- a. në planifikimin e shtimit në gjendje gjysëm të lirë të këtyre llojeve dhe lëshimin e tyre në jetën e egër;
- b. ndërtime të thjeshta që lehtësojnë strehimin dhe në dobi të llojeve të faunës së egër, si psh. çerdhe apo mjedise për të pirë ujë si dhe forma të tjera që mundësojnë një fasilitet në kushtet e vështira të motit;
- c. sigurimin e ushqimit nëpërmjet mbjelljes së bimëve dhe llojeve të tjera të ushqimit suplementar të gatshëm për periudhën e ngricave dhe të ftohtit të dimrit, etj.

Masat do të shoqërohen me një buxhet të planifikuar për realizimin e secilës prej tyre si dhe një kosto totale vjetore për zonën e gjuetisë.

Mbi bazën e të dhënave dhe analizave përkatëse për cdo zonë gjuetie, krahas planifikimeve për llojet e faunës së egër, do të bëhen planifikime për ndërhyrje e përmirësime edhe në vetë zonat e gjuetisë, në të gjithë treguesit e tyre. Ndër të tjera, pasqyrimi i situatës dhe këto investime e ndërhyrje përmirësuese duhet të përfshijnë:

- a. ndërhyrje e përmirësime në drejtim të vendosjes, plotësimit apo përmirësimit të shenjave dalluese që pasqyrojnë kufizimin/kufirin e zonës së gjuetisë;
- b. ndërhyrje e ndërtime të thjeshta në dobi të gjuetarëve, si psh. pika vrojtimi të shpendëve apo ngritja e ambjenteve (fasiliteteve) të thjeshta për çlodhje dhe rekreacion;
- c. përmirësime të infrastrukturës së brendëshme të zonës, që kanë të bëjnë me vendosjen e tabelave orientuese që japin informacion për zonën e gjuetisë, të cilat duhet të vendosen në pozicione të dukshme dhe me ngjyra që bien në sy lehtësisht. Në këto tabela duhet të jepen:
 - i. kufijtë dhe madhësia e zonës;
 - ii. kufijtë e sipërfaqeve që nuk lejohet gjuetia, në se ka të tilla;
 - iii. pikat hyrëse dhe dalëse në zonë (duke identifikuar rrugët e mundshme të kalimit të gjuetarëve në zonën e gjuetisë - pozicionimi i pikave të hyrjes dhe daljes bëhet në pika strategjike dominuese të zonës së gjuetisë, nëpërmjet të cilave menaxhuesi të mund të kontrollojë lëvizjet në zonë);
 - iv. përcaktime/informime të nevojshme për kufitarët e zonës së gjuetisë, etj.

Planifikimi financiar do të shoqërojë të gjithë ndërhyrjet e nevojshme përmirësuese në vetë zonën e gjuetisë.

Bashkëpunimi me federatat, shoqatat e gjuetarëve si dhe NGO-të e fushës së natyrës në procesin e investimeve, projekteve dhe ndërhyrjeve përmirësuese në zonat e gjuetisë duhet të jetë i vazhdueshëm. Ministria e Mjedisit brenda kohës së moratoriumit të gjuetisë, të iniciojë dhe hartojë një plan afatgjatë bashkëpunimi me këto struktura për këtë proces që do realizohet në zonat e gjuetisë.

VII. SHTIMI I POPULLATAVE TË LLOJEVE, OBJEKT GJUETIE DHE SHPËRNDARJA E INDIVIDËVE NË ZONA

Për të vlerësuar efektin e ndërhyrjeve, të realizuara apo që do të realizohen në kuadrin ligjor, që synojnë një mbrojtje të biodiversitetit e jetës së egër më cilësore e në një terren gjithnjë më të zgjeruar, Ministria e Mjedisit të bëjë në vazhdimësi monitorim të këtij procesi. Brenda periudhës së moratoriumit, ministria të krijojë një sistem të mbajtjes së të dhënave për këtë qëllim, ku të

pasqyrohet kompleksi i të dhënave të nevojshme lidhur me ecurinë e popullatave të faunës së egër objekt gjuetie.

Konstatimet pozitive në këtë drejtim, të shtyjnë procesin e ndërhyrjeve të tjera në kuadrin ligjor për të zgjeruar më tej mundësitë e mbrojtjes së faunës së egër objekt gjuetie, por natyrisht pa cënuar të drejtën për të gjuajtur dhe pa cënuar barazpeshën që duhet të ekzistojë midis kësaj veprimtarie dhe zhvillimit të qetë e normal të jetës së egër, vecanërisht asaj objekt gjuetie

Për të bërë të mundur shtimin e popullatave të llojeve objekt gjuetie dhe shpërndarjen e individëve në zona, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor të fillojnë procedurat për shpalljen e zonave të ripopullimit, mbështetur në ligjin “Për gjuetinë”, për ato lloje objekt gjuetie që rezultojnë të pakësuara në mënyrë të ndjeshme.

Për ripopullimin e zonave të gjuetisë, Ministria e Mjedisit do të planifikojë që nëpërmjet financimeve nga buxheti i saj të ngrihen dy ferma për kultivimin e specieve objekt gjuetie deri më 2018 dhe tre të tjera në periudhën në vijim pas vitit 2018.

Ministria e Mjedisit nëpërmjet projekteve të fushës së natyrës, do të bëjë të mundur planifikimin e rritjes dhe mbarështimit të llojeve objekt gjuetie me synim lëshimin e tyre në zonat e gjuetisë, veçanërisht në ato që kanë nevojë për ripopullim.

Ministria e Mjedisit do të bashkëpunojë me shoqatat e gjuetarëve për të hartuar dhe financuar projekte pilot për ripopullimin e zonave të gjuetisë, duke patur si përparësi shtimin e atyre llojeve të faunës së egër objekt gjuetie, popullatat e të cilave janë në rënie të ndjeshme.

DRSHP të planifikojnë që nëpërmjet buxheteve të tyre, të blejnë për ripopullim lloje të faunës objekt gjuetie nga rezervatet ekzistuese të mbarështimit të faunës, apo nga rezervate të tjera që do mund të ngrihen.